

**UNIVERSITETI I GAKOVËS “FEHMI AGANI”**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI FILLOR**



**STUDIME BACHELOR**

# **PUNIM DIPLOME**

**Tema: Strategji të mësimdhënies dhe të nxënit**

**Udhëheqësi Shkencor:**

Prof. Ass. Dr: Shefqet Mulliqi

**Kandidatja:**

Dafina Gashi

**Gjakovë, 2017**

## FALENDERIM

Shtjellimi dhe realizimi i kësaj teme do të ishte i pamundur pa përkrahjen dhe mbështetjen e personave të shënuar më poshtë.

Fillimisht dua të falenderoj gjithë stafin profesional të profesorëve të Departamentit të Programit Fillor të Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani” për kontributin dhe angazhimin e palodhshëm gjatë këtyre 4 viteve të studimit, kam bindjen se do vazhdojnë edhe më fuqishëm me punën e tyre për gjeneratat që do të vijnë.

Falenderim, mirënjohje dhe respekt për mentorin e temës Prof. Ass. Dr. Shefqet Mulliqi, për këshillat e vyera dhe gatishmërinë e tij ndaj meje, për inkurajimin që më ka dhënë në realizimin e këtij objekti të rëndësishëm që i kisha përcaktuar vetës.

E ndjej për obligim të falenderoj Stafin Udhëheqës, Mësimdhënësit dhe nxënësit e Shkollës së Mesme të Ulët “Haxhi Hoti” - Rogovë, ku kam ushtruar Mësimin Praktik gjatë studimit. Njerëzit me të cilët punova aty dhe shkëmbyem përvojat të cilat për mua ishin vendimtare për realizimin sa më profesional dhe të kompletimit si mësimdhënëse e ardhshme. Falenderim të posaçëm për shoqërinë dhe kolegët e fakultetit!

Së fundi, por jo për nga rëndësia, falenderoj familjen time të cilët më mbështeten gjatë kohës së studimeve moralisht dhe financiarisht. I falenderoj për durimin dhe mirëkuptimin që kanë dëshmuar si gjatë këtyre 4 viteve dhe posaçërisht kohët e fundit, kur po merresha me hartimin e punimit. Falënderime të pakufishme!

Falënderoj Zotin që mi ka dhënë të gjitha mundësitë në jetë!

Për fund dua të shfrytëzoj një thënie në formë betimi nga Sokrati që më ka udhëhequr deri tani:

*Betohem se do të përpigem me të gjitha forcat dhe aftësitë e mia, të jem në shërbim të arsimit të secilit prej nxënësve që do të më besohen.*

*Dafina Gashi*

Gjakovë, 2017

## **ABSTRAKT**

Ndërtimi dhe zhvillimi i partneritetit mes mësimehdënësive dhe nxënësive, po shfaqet si një ndër tematikat më aktuale në diskutimet dhe qasjet profesionale të drejtuesve të institucioneve shkollore, mësuesve, specialistëve dhe kërkuesve shkencor të fushës së edukimit duke u munduar vazhdimisht që të gjejnë forma dhe strategji se si ti çasen kësaj problematike dhe të rezultojnë metodat më të përshtatshme të kohës dhe nevojës në varësi të situatës dhe ambientit të punës.

Studimi në vijim, i titulluar “Strategji të mësimehdënies dhe të nxënies”, është zhvilluar në kuadër të programit të studimeve themelore në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”. Përmes studimit të realizuar pikërisht në fushën e strategjive dhe metodave është synuar të paraqitet jo vetëm një analizë që nga mësuesi, mësimehdënien dhe mësimehdënien e deri te format e qasjes për një edukim të mirëfilltë. Krahas kësaj shtjellimi i punimit është orientuar edhe në raste konkrete të studimit në formë të hulumtimit ku janë zhvilluar anketa me mësimehdënës dhe nxënës. Kjo si një pjesë e shtuar e punimit nga e cila mund të nxjerrim përfundimet më të mira.

Pra shkurtimisht mund të themi se: Studimi analizon disa nga aspektet dhe karakteristikat e mësimehdënies dhe të nxënies me theks të veçant strategjive të tyre, planifikimin dhe realizimin.

Fjalët kyçe: mësuesi, mësimehdënësia, mësimehdënësia, planifikimi, strategjitë...,etj.

# PËRMBAJTJA

HYRJE.....	6
KAPITULL I.....	7
1. Mësuesi.....	7
1.1. Mësimdhënie e mirë, mësues i suksesshëm.....	7
1.2. Karakteristikat kryesore që ndikojnë në mësimdhënien produktive.....	8
1.2.1. Qartësia në mësimdhënie.....	9
1.2.2. Llojshmëria në mësimdhënie.....	9
1.2.3. Orientimi në detyrë.....	9
1.2.4. Përfshirja në procesin e të nxënësve.....	10
1.2.5. Shkalla e suksesit të nxënësve.....	10
KAPITULL II.....	11
2. Mësimdhëniet efektive / mësimdhënësi efektiv.....	11
2.1. Teoritë e të nxënësve.....	12
2.2. Stilet e të nxënësve / mësuarit.....	13
2.3. Procesi, stilet e të nxënësve dhe inkluzioni.....	14
KAPITULL III.....	16
3. Planifikimi i mësimit.....	16
3.1. Njohuritë e mësuesit si vendimmarrës.....	17
3.1.1. Njohuritë për qëllimet dhe objektivat mësimore.....	17
3.1.2. Njohuritë për nxënësin.....	17
3.1.3. Njohuritë për lëndën.....	18
3.1.4. Njohuritë për metodat mësimore.....	18
3.2. Përbërësit e Planit Ditor.....	18
3.3. Struktura për mësimdhënien dhe zhvillimin e të menduarit.....	19
3.3.1. Mendimi kritik dhe struktura ERR.....	19
3.3.2. Evokimi.....	20
3.3.3. Realizimi i kuptimit.....	21
3.3.4. Reflektimi.....	21
KAPITULL IV.....	22
4. METODA DHE STRATEGJI TË MËSIMDHËNIES.....	22

4.1.	Përmbledhja e Strukturuar .....	22
4.2.	Di – Dua të di - Mësova (DDM) .....	23
4.3.	Shkrim i Shpejtë .....	24
4.4.	Stuhia e Mendimeve .....	24
4.5.	Stuhi Mendimesh në Dyshe .....	25
4.6.	Lëviz/Ndalo/Krijo Dyshe .....	25
4.7.	Lapsat në Mes.....	26
4.8.	Shkëmbe një Problem .....	27
4.9.	Ruaje fjalën e fundit për mua.....	28
4.10.	Shkrim i Lirë .....	29
4.11.	Ditari Dypjesësh.....	29
4.12.	Studimi në Dyshe .....	30
Kapitulli V .....		31
5.	Rezultatet e hulumtimit.....	31
5.1.	Rezultatet e Hulumtimit me Mësimdhënës .....	31
5.2.	Rezultatet e Hulumtimit me Nxënës.....	35
Përfundimi.....		39
Literatura.....		40

## **HYRJE**

*“Një profesion nuk krijohet nga certifikatat dhe cenzurat, por nga ekzistenca e njohurive të mjaftueshme profesionale, ekzistenca për t’i përmirësuar ato dhe nga një dëshirë e vërtetë e anëtarëve të këtij profesioni për të përmirësuar praktikën e tyre.”*

**Stigler dhe Hiebert (1999)**

Në këtë punim diplome trajtohet tema “Strategji të mesimdhënies dhe të nxënit”, tema kryesisht flet për gjithë punën e mësuesit, mesimdhënien efektive, stilet e të nxënit, strategjitë dhe metodat që mësuesit përdorin në mesimdhënie...etj.

Në pjesën e parë të punimit do të hasni kryesisht me punën që e bën mësuesi, mesimdhënien e mirë, mësuesin e suksesshëm, karakteristikat që ndikojnë në mesimdhënien produktive, etj. Ndërsa në pjesët tjera të punimit do të njiheni me mesimdhënien efektive/mesimdhënësin efektiv, teorit e të nxënit, stilet e të nxënit, planifikimin e mësimit, struktura e orës mësimore, metoda dhe strategji të ndryshme të mesimdhënies.

Pjesa e fundit përmbillet me rezultatet e një hulumtim, hulumtim ky i realizuar gjatë punimit të temës, ku pjesëmarrës janë mesimdhënësit dhe nxënësit. Qëllimi kryesor i hulumtimit ishte që të informoheshin me strategjitë dhe metodat që mesimdhënësit i përdorin në punën e tyre, dhe po ashtu të shihja sa pëlqehen metodat mësimore nga nxënësit, dhe cilat nga ato janë më të vështira për ta, etj. Pra gjatë këtij punimi do të ndesheni me gjithë punën e organizuar nga mësuesit.

Mësuesit në veprimtarinë e tyre përdorin një sërë strategjish, metodash dhe teknikash mësimore ku nxënësit ndërveprojnë në mënyra të ndryshme organizimi.

Mesimdhënia nxit ndjenja në ngjyra të ndryshme si për mësuesit edhe për nxënësit. Është një punë ku mësuesit vazhdimisht vënë veten e tyre në linjë, është e lehtë të humbasin në panoramën e dimensionit emocional të mesimdhënies, entuziazmit, pasionit, kujdesjes, urtësisë, frymëzimit, dhe përkushtimit, duke i bërë shumë mësues të mëdhenjë.

# KAPITULL I

## 1. MËSUESI

Mësuesi është njeriu që ka për detyrë të ndihmojë të tjerët të mësojnë dhe të sillen në një mënyrë të re dhe të ndryshme nga ajo si është sillur më parë. Më parë mësuesi ishte burim informimi bazë për gjithçka, ndërsa sot, mësuesi është një udhëheqës dhe organizues i mësimit, që udhëheq nxënësin për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin dhe, me ndihmën e tij, të zgjidhë çdo problem, sado i ndërlikuar që të jetë. Sot në qendër të mësimit është nxënësi. Mësuesi rregullon e përshtat intereset dhe nevojat e tij, në përputhje me synimet e mësimdhënies.

Arsimimi, të nxënësit dhe mësimdhëniet ndodhin në mjedise të ndryshme dhe pjesa dërrmuese e shoqërive e kanë të qartë se arsimimi është shumë i rëndësishëm, prandaj, nuk mund t'i lihet rastësisë. Shkollat hapen për të dhënë një lloj përvojë arsimore, mbi bazën e synimeve të qarta dhe të një plani të caktuar, i cili quhet program dhe në kuptimin më të gjerë e që përdoret sot, kurrikula. Mësuesit përgatiten dhe punësohen nga shoqëria për të ndihmuar në realizimin e qëllimeve dhe objektivave të programit.

Disa vite më parë, në vendet e Evropës Perëndimore lindi një prirje, procesi i ashtuquajtur “universitarizim i përgatitjes së mësuesve”. Sot të tëra këto vende, e kanë ngritur në nivelin universitar përgatitjen e mësuesve, duke e reformuar tërësisht këtë sistem. Madje, për t'i rritur edhe statusin mësuesit në shoqëri, në disa prej këtyre vendeve, mësuesit klasor (cikli i ulët) i jepet titulli “Profesor”, në përfundim të studimeve.

### 1.1. MËSIMDHËNIE E MIRË, MËSUESI SUKSESSHËM

Mësimdhëniet e mirë është vështirë të përcaktohet, sepse termi i mirë ka shumë ngjyrimet emocional. Ajo që mund të duket mësimdhënie e mirë për njërin, për një tjetër mund të jetë e keqe, sepse secili vlerëson përfundime apo metoda të ndryshme. Një mësues mund ta drejtojë klasën në mënyrë shumë të organizuar dhe me etapa të qarta, duke e vënë theksin tek përmbajtja intelektuale e lëndëve mësimore. Një tjetër mund ta drejtojë klasën me etapa jo shumë të ngurta, duke i lënë nxënësit më tepër të lirë për ta përzgjedhur përmbajtjen dhe veprimtaritë që u interesojnë vetë atyre.<sup>1</sup>

Mësimdhëniet e “mirë” është vështirë të përcaktohet, ndërsa mësimdhëniet “e suksesshme” mund të vërtetohet. Mësuesi i suksesshëm quhet ai që është në gjendje të realizojë qëllimet dhe objektivat e programit, përmasat kryesore të mësimdhënies së suksesshme janë dy: synimi dhe

---

<sup>1</sup> Musai Bardhyl Psikologji Edukimi - Tiranë : PEGI, 1999. - Vol. I.

rezultatet. Pa synime, rezultatet e nxënësit bëhen të rastësishme dhe pa kritere. Megjithatë edhe vetëm synimet nuk janë të mjaftueshme. Në qoftë se nxënësi nuk i realizon objektivat e përcaktuara të të nxënës (madje edhe kur mungesa e sukseseve dhe dështimet nuk varen dhe nuk janë në dorë të mësuesit), atëherë nuk mund të thuhet se puna e mësuesit ka qenë me të vërtetë efektive.<sup>2</sup>

Mësuesit e suksesshëm janë ata, të cilët mund të vërtetojnë aftësinë e tyre për të realizuar rezultatet e planifikuara. Studimet tregojnë se mësuesit e suksesshëm janë të drejtë, demokratë, të përgjegjshëm, të kuptueshëm, të dashur, nxitës, origjinalë, syçelët, tërheqës, të ekuilibruar, të matur dhe me besim në vetvete. Mësuesit me rezultatet të dobëta përkufizohen si të njëanshëm, monotonë, të hallakatur, të pasigurtë, inatçorë dhe me gabime në punë.

Mësuesi duhet t'i njohë mirë fëmijët dhe të ndjekë zhvillimin e tyre në çdo etapë. Ai duhet të dijë diçka edhe për mjedisin jashtë klasës dhe shkollës. Ai duhet ta njohë mirë përmbajtjen e lëndës që jep dhe të dijë të dallojë thelbësoren, nga ajo që është anësore dhe e rastësishme. Ai duhet të mishërojë një tërësi vlerash morale, të cilat e udhëheqin atë në rolin e tij si mësues. Mësuesi duhet të dijë si nxënë fëmijët, nxënësit dhe të rriturit dhe të krijojë mjedisin që e lehtëson të nxënë.

## ***1.2. KARAKTERISTIKAT KRYESORE QË NDIKOJNË NË MËSIMDHËNIEN PRODUKTIVE***

Janë përcaktuar afërsisht 10 karakteristika që tregojnë lidhjen midis rezultateve të dëshirueshme të nxënësve, të përcaktuara përmes testeve dhe instrumenteve të tjera të vlerësimit. Nga këto, pesë janë përcaktuar si karakteristika kryesore, pesë të tjera janë quajtur ndihmëse, por edhe ato, të lidhura në mënyrë logjike me mësimdhënien produktive<sup>3</sup>. Pesë të parat do t'i quajmë kryesore, pasi me të vërtetë janë konsideruar të tilla, dhe të dytat do t'i quajmë ndihmëse.

Pesë karakteristikat kryesore janë<sup>4</sup>:

1. Qartësia në mësimdhënie
2. Llojshmëria në mësimdhënie
3. Orientimi në detyrë
4. Përfshirja në procesin e të nxënës
5. Shkalla e suksesit të nxënësve

---

<sup>2</sup> MASHT Mësuesi i Kosovës [Article]. - Prishtinë : Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Shkurt 2014.

<sup>3</sup> Sulollari E Profesionalizmi i mesuesit [Online] // Mësimdhënia. - Maj 5, 2017. - <https://sites.google.com/site/mshesmeraldasulollari/>

<sup>4</sup> Gary D. Borich - Përkthyer nga Bardhyl Musai Metodologji e Mësimdhënies - Tiranë : ALBGRAF, 2003. - Vol. III.



### **1.2.1. Qartësia në mësimdhënie**

Kjo karakteristikë kryesore ka të bëjë me qartësinë e paraqitjes, së mësimimit në klasë, e treguar përmes karakteristikave të mëposhtme të mësuesit të suksesshëm:

- Ata paraqesin dhe i bëjnë çështjet mësimore të kuptueshme.
- Përshkruajnë dhe u shpjegojnë qartë konceptet nxënësve dhe janë në gjendje të ndjekin një linjë logjike të rregullt, hap pas hapi.
- Të folurit e tyre është i qartë, i pranueshëm për nxënësit dhe i çliruar nga fjalët e panevojshme e të pakuptimta.

Sjelljet e mësuesit varen, në mënyrë të konsiderueshme, nga qartësia. Qartësia është një sjellje komplekse e mësuesit dhe është e lidhur me të ashtuquajturat sjellje kognitive, si organizimi i përmbajtjes, familjarizimi me përmbajtjen dhe mënyrat e mësimdhënies (nëse do të përdoret diskutimi, pyetjet apo puna në grupe, etj.). Por që të dyja, qartësia kognitive dhe ajo gojore e paraqitjes, ndryshojnë shumë nga një mësues tek një tjetër.

### **1.2.2. Llojshmëria në mësimdhënie**

Kjo sjellje kryesore ka të bëjë me llojshmërinë apo mënyrën e dhënies së mësimimit, një nga mënyrat më të efektshme të krijimit të llojshmërisë në mësimdhënie është të pyeturit. Në mësim mund të bëhen pyetje të shumëta dhe, kur ato integrohen natyrshëm, krijojnë një varacion të këndshëm dhe të kuptimshëm. Kështu mësuesit e suksesshëm e kanë të nevojshme të zotërojnë artin e të pyeturit, procesin e pyetjeve, pyetjet konvergjente (pyetje që kanë një përgjigje të vetme të saktë) dhe divergjente (pyetje për të cilat nuk ka një përgjigje të vetme të saktë).

Një tjetër aspekt i llojshmërisë në mësimdhënie, por edhe më i rëndësishmi është përdorimi i materialeve për të nxënë, pajisjeve; vendosja e punimeve të nxënësve në mure apo raftë, përdorimi i mirë dhe me kujdes i hapësirës në klasë. Mjedisi fizik dhe pamja e klasës ndihmojnë në llojshmërinë e mësimdhënies. Kjo ndikon, më pas, në rezultatet e nxënësve, përfshirjen e tyre në procesin e të nxënësve etj.

### **1.2.3. Orientimi në detyrë**

Orientimi në detyrë është një element tjetër kryesor që ka të bëjë shumë me kohën që i kushtojnë mësuesit detyrës për mësimdhënien e temës apo të çështjeve të reja të mësimimit. Sa më shumë kohë t'i kushtohet detyrës për mësimdhënien e një teme të caktuar, aq më shumë mundësi do të kenë nxënësit për të nxënë.

Disa pyetje të lidhura me orientimin në detyrë janë:

- Sa kohë më duhet për përdorimin e metodave për dhënien e mësimit të ri, si p.sh, shpjegimi, pyetjet, ushtrimi i nxënësve në punë, për të menduar në mënyrë kritike dhe të pavarur etj.?
- Sa kohë më duhet për të organizuar nxënësit që të jenë të gatshëm për të nxënë?
- Sa kohë më duhet për të vlerësuar punën e nxënësve, për të parë shkallën e të nxënit?

Këto pyetje janë të lidhura me materialin që paraqitet, mësohet dhe vlerësohet, dhe janë të lidhura me kohën tjetër të nevojshme për çështje procedural dhe organizative. Të gjithë mësuesit duhet t'i përgatisin nxënësit për të nxënë dhe, për më tepër, në një mënyrë të tillë, që ky proces t'u japë kënaqësi.

#### **1.2.4. Përfshirja në procesin e të nxënit**

Përfshirja e nxënësit në procesin e të nxënit është një sjellje kryesore që ka të bëjë me kohën që i kushtohet të nxënit të mësimit. Kjo është e lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me rezultatin e nxënësit. Orientimi në detyrë i mësuesit i siguron nxënësit mundësi të mëdha për të nxënë materialin për të cilin, më pas, ai do të vlerësohet. Në dallim nga koha që mësuesi i kushton mësimit, është edhe koha që i duhet nxënësit për të nxënë. Kjo quhet koha e përfshirjes aktive në të nxënë e materialit. Sa më shumë që nxënësi të jetë i përfshirë, aq më i madh do të jetë edhe rezultati në të nxënë.

#### **1.2.5. Shkalla e suksesit të nxënësve**

Ka të bëjë me shkallën e të kuptuarit të detyrave dhe saktësisë në plotësimin e detyrave, ushtrimeve, testeve etj. Aspekti kryesor i lidhur me orientimin e nxënësit në detyrë është vështirësia e materialit të ri. Niveli i vështirësisë përcaktohet nga shkalla e të kuptuarit saktë të ushtrimeve dhe detyrave. Këto tre nivele të vështirësisë janë si më poshtë:

- Suksesi i plotë. Nxënësi kupton detyrën dhe, mjaft rrallë, bën gabime që vijnë nga pakujdesia.
- Sukses i pjesshëm. Nxënësi kupton, në mënyrë të pjesshme, por bën disa gabime të rënda.
- Sukses i ulët. Nxënësi nuk e kupton fare detyrën.

Studimet dhe përvoja kanë treguar se orientimi në detyrë dhe shkalla e përfshirjes së nxënësit janë të lidhura ngushtësisht me shkallën e suksesit të nxënësit.

## KAPITULL II

### 2. MËSIMDHËNIA EFEKTIVE / MËSIMDHËNËSI EFEKTIV

Mësimdhënia është një proces shumë i komplikuar. Duhet bërë shumë gjëra njëherësh. Por, pavarësisht nga kjo, ekzistojnë disa elemente psikologjike, didaktikë, social që ndihmojnë në realizimin e një mësimdhënieje efektive. Mësimdhënia efektive është bazë për të nxënë të suksesshëm. Bën lidhje me jetën reale, zhvillon të kuptuarit e thellë dhe monitoron e reflekton mbi të nxënë. Një mësimdhënie efektive nuk lidhet thjesht me informimin e nxënësve, kjo do të ishte gjëja më e thjeshtë.

Dihet se mësuesi merr shumë vendime gjatë ditës mësimore, duke nisur që nga vendosja e mjeteve mësimore, nga përcaktimi i objektivave dhe i metodave të shpjegimit, kontrollimin e detyrave dhe njohurive, motivimin e nxënësve, etj. Edhe kur nxënësit janë duke punuar në mënyrë të pavarur apo në grupe, përsëri janë të ndikuar nga vendimet që kanë marrë mësuesit për ndarjen në grupe, për mënyrën e ndërtimit të pyetjeve etj. Por nxënësit nuk janë pjesëmarrës pasiv që presin të mbushen me njohuri.

Disa nga veçorit e kërkesave që lidhen me mësuesit për një mësimdhënie efektive<sup>5</sup>:

- Fillojnë menjëherë mësimin dhe janë të mirëorganizuar.
- Mësojnë me një ritëm të përshtatshëm, por ndalen rregullisht për të kontrolluar të kuptuarit e fëmijëve dhe përfshirjen e tyre në punë.
- Përdorin një shumëllojshmeri strategjish, jo vetëm shpjegimin.
- Fokusohen tek tema dhe objektivat e tyre mësimore dhe nuk dalin jashtë tyre. Shpjegimi është i qartë.
- Përdorin humorin duke ruajtur stilet e tyre individuale.
- Praktikojnë teknika të mira menaxhuese të klasës, duke mbajtur vëmendjen dhe respektin për grupin.
- Ndërveprojnë me nxënësit duke dhënë përgjegjje të menjëhershme për pyetjet apo komentet.
- Çmojnë përgjigjet e nxënësve dhe përdorin pyetjet hetuese për të zgjeruar përgjigjen.
- Sigurojnë një klimë të ngrohtë në klasë duke i lejuar nxënësit të flasin lirshëm duke përdorur humorin personal ose përpjekje të tjera për të treguar lidhje njerzore me nxënësit. Përdorin sjellje jo verbale, si gjeste, ecje, kontaktin me sy, për të përforcuar komentet që bëjnë etj.

---

<sup>5</sup> Marigona [Online] // Mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive. - Scribd, Mars 11, 2016. - 1.0. - Maj 10, 2017. - <https://www.scribd.com/doc/303932988/Mesimdhenea-Dhe-Mesimnxenia-Efektive>.

## **2.1. TEORITË E TË NXËNIT**

Të nxënit gjithmonë përfshinë një ndryshim të qëndrueshëm në personin që nxë, mëson. Ndryshimi mund të mos jetë i paramenduar apo i parashikuar, për mirë apo për keq. Për t'u klasifikuar si të nxënë ky ndryshim mund të sillet me anë të përvojës, prej ndërveprimit të personit me mjedisin e tij. Me këto dy koncepte, ndryshimi dhe përvoja, mund të formulojmë përkufizimin e të nxënit. Të nxënit është një ndryshim në një person që vjen si rezultat i përvojës.

Sipas këndvështrimit Bihevjorist të nxënët është një ndryshim në sjellje, në mënyrë sipas së cilës një person vepron në një situatë të veçantë. Sot përfaqësuesi më tipik i Bihevjorizmit mbetet Skinneri. Të nxënët është një ndryshim i brendshëm në një person, formimi i lidhjeve të reja ose potenciali për reagime të reja. Të nxënët është një proces që ndodhë brenda një personi (pikëpamja kognitive), por gjithashtu thekson rëndësinë e ndryshimeve në sjelljen e vëzhgueshme si tregues që të nxënët ka ndodhur (pikëpamja bihevjoriste).

Teoritë e të nxënit<sup>6</sup>:

- Të nxënit Bihevjorist - Informacion për reagimet/qëndrimet, përforcim pozitiv, negativ, neutral, nxitja për reagim specifik, i jashtëm – i brendshëm, motivim për sjellje të saktë.
- Të nxënit Kognitiv – Regjistrat shqisor, kujtesa (afatgjatë/afatshkurtër), përsëritja, organizimi i të kuptuarit, të nxënit aktiv dhe zotërimi i plotë, lidhja e ideve mes tyre, respektimi i lidhjeve shkakore, organizuesit e avancuar.
- Të nxënit Social – Vëmendja, ruajtja, prodhimi i sjelljes, motivimi për ta ruajtur sjelljen e re, vetefikasiteti, agresioni, qëndrueshmëria, vetëbesimi.
- Të nxënit Konstruktiv – Interpretimi i ideve nga këndvështrimi personal, vendi i debatit dhe diskutimi, vendi i projekteve, i praktikave dhe prespektivave të shumfishta.
- Të nxënit përpunimi i informacionit – Caktimi i qëllimit, gjetja e teknikave, fjalët kyçe, organizimi i informacionit sipas kuptimit, planifikimi, monitorimi, modifikimi.

---

<sup>6</sup> Marigona [Online] // Mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive. - Scribd, Mars 11, 2016. - 1.0. - Maj 10, 2017. - <https://www.scribd.com/doc/303932988/Mesimdhenea-Dhe-Mesimnxenia-Efektive>.

## **2.2. STILET E TË NXËNIT / MËSUARIT**

Stilet e të nxënit nga autor të ndryshem emërtohen si mënyrë përmes të cilave merrën të dhëna, dije, informacione të cilat përvetësohen dhe përpunohen nga nxënësit në mënyrë vetanake. Stilet e të nxënit në vetëvete kanë elementin e përceptimit (të parit, dëgjuarit, prekurit, ndjenjës, të menduarit, veprimt). Prandaj çdo nxënës ka mënyrën e vet të të nxënit, Çdo here duhet pasur parasysh se mësimi më i mirë bëhet kur nxënësi mëson duke u nisur nga interesat, dëshirat dhe pa detyrime e ngarkesa.

Të mësuarit është i frytshëm nëse të folurit, bisedat, shoqerohen, ndërlihen me veprime, ushtrimet duke punuar, vepruar etj. Karakteristikat, mënyrat se si nxënësi punon, arrin deri te informatat dhe si mëson janë çështje që duhet të njihen në mënyrë profesionale nga mësimdhënësi si dhe të trajtohet si një faktorë i veçantë në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit. Kjo nënkupton përshtatjen e strategjive mësimore, mësimdhënies me stilet e të nxënit për të arritur një mësimdhënie cilësore, të frytshme.

Stilet e të mësuarit zakonisht përkufizohen si tipare njohëse, emocionale dhe psikologjike të nxënësve, kur ata bashkëveprojnë në mjedisin e klasës. Nxënësit me stile të ndryshme përpiqen t'i zgjidhin problemet në mënyra të ndryshme. Pra duke i njohur stilet e të nxënit, mësimdhënësi njihë karakteristikat e nxënësve, mënyrën e përvetësimit të diturive, zgjidhjes së situatave problemore.

Për stilet e të nxënit kanë shkruar autorë të ndryshem, si në literaturën e ndryshme psikologjike ashtu edhe në atë pedagogjike. Psikologu amerikan Kolb dallon këto stile të të nxënit<sup>7</sup>:

- Stili i të nxënit nëpërmjet eksperiencës konkrete (të nxënit nëpërmjet përvojës, shembujve konkret etj).
- Stili i të nxënit nëpërmjet eksperimenteve aktive (përvetësimi i dijeve nëpërmjet bashkëveprimit, punës në grupe, bashkëbisedimit).
- Stili i të nxënit me ndihmën e monitorimit (të mësuarit përmes vëzhgimit, përdorimi i materialeve të ndryshme).
- Stili i të ashtuquajtur mendim-konceptualizim abstrakt (të nxënit duke përdorur proceset mendore, analizën, të menduarit logjik, gjykimin).

---

<sup>7</sup> Marigona [Online] // Mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive. - Scribd, Mars 11, 2016. - 1.0. - Maj 10, 2017. - <https://www.scribd.com/doc/303932988/Mesimdhenea-Dhe-Mesimnxenia-Efektive>.

Përveq këtyreve renditjeve të stileve të të nxënimit kemi edhe renditjen tjera të ngjajshme sikur:

- Stili i të nxënimit aktiv – Nxënësit që mësojnë sipas këtij stili i përvetësojnë dijet, u shpjegojnë të tjerëve, diskutojnë dhe ndërveprojnë. Prandaj edhe pëlqejnë të punojnë në grupe, të veprojnë, ku secili anëtarë i grupit bashkëpunon për dhënien e ideve dhe zgjidhjen e problemeve, janë më energjik dhe kanë prirje për veprimtari ku kërkohet gjallëri.
- Stili i të nxënimit reflektiv – Derisa nxënësit aktiv punojnë në grupe, nxënësit reflektiv parapëlqejnë të punojnë në mënyrë vetanake, në një vend të qetë, larg zhurmës dhe gjërave tjera që mund ta pengonin të menduarit e tyre rreth dijeve dhe informacioneve të përfituara.
- Të nxënimit intuitiv – Nxënësit me intuitë janë shumë logjik, mendojnë, analizojnë, krahasojnë, kanë të zhvilluar të menduarit abstrakt, gjejnë mardhënjet dhe janë nismëtar të risive.
- Nxënësit e ndjeshëm – Nxënësit që ndjejnë i përvetësojnë dijet, faktet dhe i kuptojnë ato. Janë të kujdesshëm për gjërat më të imta dhe dallohen për vendosmëri në zgjidhjen e problemeve. Pëlqejnë të kryejnë veprime praktike edhe mësimet të konkretizohen me shembuj praktik.
- Stili i të nxënimit pamor – Nxënësit që kanë prirje pamore i përvetësojnë informacionet kur ato janë konkrete dhe i shohin si p.sh. ilustrimet, hartat, cd. rom etj.
- Stili i të nxënimit dëgjimor – Këta nxënës më parë pëlqejnë të mësojnë prej fjalës së folur dhe të shkruar, përmes ligjeratave, diskutimeve në grupe etj.
- Stili kronologjik – Parapëlqejnë të mësojnë përmbajtje mësimore duke i ndarë në pjesë më të vogla logjike dhe pa bërë shkopitje të lidhshmërisë së tyre logjike.
- Stili global – Shquhet për prirje të zgjedhjes së problemeve në tërësi ashtu si janë dhe pa hyrë në imtësira.

### ***2.3. PROCESI, STILET E TË NXËNIMIT DHE INKLUZIONI***

Mbi procesin e të nxënimit ka shumë teori dhe gjithashtu klasifikime të shumta të stileve të të nxënimit, por janë tri mënyra kryesore (kyçe) të të nxënimit që mund të klasifikohen si<sup>8</sup>:

- **Vizuale**
- **Auditive**
- **Kinestetike**

Të gjithë ne kemi element të secilit stil të të nxënimit, megjithëse, zakonisht ne kemi preferencë për njërin nga stilet e mësipërme. Po kështu ndodhë edhe me nxënësit.

---

<sup>8</sup> Marigona [Online] // Mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive. - Scribd, Mars 11, 2016. - 1.0. - Maj 10, 2017. - <https://www.scribd.com/doc/303932988/Mesimdhenea-Dhe-Mesimnxenia-Efektive>.

Mësuesi mund ta përdorë stilin e të nxënit të fëmijës për ta inkurajuar atë të nxënë, për ta motivuar dhe për ta bërë që të ndjehet i suksesshëm. Megjithatë, mësuesi duhet gjithashtu ta inkurajojë nxënësin të provojë stilet e ndryshme dhe ta mësojë se si të përdorë secilin prej tyre në jetë.

- **Të nxënit Vizuel** – Preferon pikturën, diagramet e grafikët, ka nevojë të krijojë pamje apo përfytyrime mendore të gjalla për të ruajtur informacionin, pëlqenë të vëzhgojë hartat, grafikët, piktura dhe video.
- **Të nxënit Auditiv** – Mëson më mirë përmes leksionit verbal, diskutimeve, duke thënë mendimet e tij por njëkohesisht duke dëgjuar atë që të tjerët thonë. Interpretin kuptimin e gjërave thelbësore në një fjalim përmes dëgjimit të tonit, lartësisë dhe shpejtësisë së zërit, etj. Informacioni i shkruar mund të ketë shumë pak kuptim për të në qoft se ai mund ta dëgjojë atë.
- **Të nxënit Kinestetik** (prekja fizike) – Shprehet përmes lëvizjeve dhe me ndërveprim në hapësirën përreth tij. Ka një sens të mirë ekuilibri dhe kordinimi të syrit e dorës, p.sh. lojërat me top. Pëlqen kërcimin, sportet, eksperimentet, përdorimin e gjuhës trupore, veprimin, përdorimin e duarve për të krijuar ose ndërtuar.

## KAPITULL III

### 3. PLANIFIKIMI I MËSIMIT

Planifikimi është detyra kryesore e mësuesit pasi ai duhet të ndërtojë veprimtari mësimore, të cilat përbushin arritjen e rezultateve të të nxënësve që parashikohen në objektiva. Në fillim të mësimit është e nevojshme që mësuesi të ketë ide se ç'loj i të nxënësve është i përshtatshëm për nxënësit e tij dhe, pastaj, si ta zhvillojë mësimin, që të lehtësojë të nxënësit. Tipar dallues dhe mbizotërues i mësimit është, si veprimtari e organizuar, është procesi i emërtuar planifikim. Për të dhënë mësim para nxënësve në mënyrë sistematike, duhet t'i kushtojmë planifikimit një pjesë të konsiderueshme të kohës dhe veprimtarisë, duke vendosur kështu, se çfarë dhe si doni që të mesojnë nxënësit.<sup>9</sup>

Mësuesit model shfaqin tre tipare të përbashkëta:

1. Zotërojnë shprehje shumë të organizuara planifikimi,
2. U përcjellin ose u transmetojnë qartë dhe me efektshmëri nxënësve objektivat e mësimit, si dhe
3. Kanë nivel të lartë kërkesash për nxënësit e tyre.

Mësuesi që të jetë i suksesshëm dhe sistematik në planifikimin e mësimit, duhet të ndërtojë për vendimet që lidhen me planifikimin, teknikat dhe aspektet metodologjike të përgatitjes së mësimit.

Mësuesit përdorin planifikimin e orës së mësimit pak a shumë ashtu si arkitektët që përdorin ndërtimin bazë, si pikënisje fillestare. Është e pamundur që të përballohet klasa gjatë 45 minutave, pa menduar se ç'duhet të mesojnë nxënësit dhe si do ta mesojnë atë që u jepet gjatë zhvillimit të orës mësimore. Duhet që të dihet me saktësi se cilat janë objektivat e orës së mësimit, cila është përmbajtja e saj dhe se si realizohen ato.

Para se të planifikohet ora e mësimit, mësuesi duhet të mesojë të planifikojë dhe të mesojë si zhvillohet mësimi. Nëse mësuesi dëshiron që të ketë sukses në punë me nxënës, duhet të mendojë me kujdes për hartimin e planit të çdo orë mësimore. Planifikimi i kujdesshëm i orës së mësimit garanton njohjen e përmbajtjes nga mësuesi. Ai ndihmon mësuesin të ketë besim në atë që bën, për nxënës të rëndësishëm të kuptojë që ora e mësimit është e përgatitur, se mësuesi i ka kushtuar kohë e vëmendje orës së mësimit.

---

<sup>9</sup> GROUP ALBAS Portali Shkollor [Online] // Bota Shkollore në një vend. - ALBAS GROUP, 2015. - Maj 13, 2017. - <http://www.portalishkollor.al/>.



Planifikimi i orës së mësimit e bën mësuesin më të strukturuar, më të organizuar, e ndihmon dhe i rendit çështjet sipas një radhe të caktuar. Njëkohësisht, ai garanton kohën optimale për çdo detyrë që jepet në klasë.

### ***3.1. NJOHURITË E MËSUESIT SI VENDIMMARRËS***

Mësuesi është një vendimmarrës dhe, si i tillë, ai duhet të zotërojë disa njohuri, me qëllim që vendimet e tij të jen të drejt dhe të merrën në çastin e duhur.

Njohuritë më kryesore që duhet të zotërojë mësuesi gjatë planifikimit janë<sup>10</sup>:

1. Njohuri për qëllimet dhe objektivat
2. Njohuri për nxënësin
3. Njohuri për lëndën
4. Njohuri për metodat mësimore

#### **3.1.1. Njohuritë për qëllimet dhe objektivat mësimore**

Përpara përgatitjes së mësimit mësuesi duhet të vendosë për përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave mësimore, këto vendime të planifikimit janë kryesore për të hartuar orë mësimore të suksesshme, pasi ato sigurojnë një strukturë të planifikimit mësimor dhe e lidhin atë me kultivimin e vlerave shoqërore dhe profesionale të mësuesit.

#### **3.1.2. Njohuritë për nxënësin**

Mësuesi e zhvillon mësimin për nxënësin, pra nxënësit janë klientët e mësuesit dhe për pasojë, që të jetë i suksesshëm, ai patjetër duhet të kuptojë dhe përceptojë nevojat e nxënësve. Faktorët që kanë ndikim më të madh në të nxënësit e nxënësve janë aftësitë dhe arritjet e tyre vetjake (duke përfshirë zellin e tyre për të nxënë, stilet e të nxënësit, konceptet për veten), shokët dhe bashkëmoshatarët, familja e tij etj. Të gjitha këto janë “dritare” përmes të cilave mësuesi vështron nevojat e të nxënësit.

---

<sup>10</sup> Musai Gary D. Borich - Përkthyer nga Bardhyl Metodologji e Mësimdhënies. - Tiranë : ALBGRAF, 2003. - Vol. III.

### **3.1.3. Njohuritë për lëndën**

Aspekt tjetër i planifikimit është zotërimi i njohurive lëndore. Zotërimi i njohurive për lëndën dhe, veçanërisht për klasën ku zhvillohet mësimi, është i domosdoshëm jo vetëm si njohuri tërësore, por edhe mënyrë e organizimit të informacionit, të koncepteve etj. Organizimi i përmbajtjes, të paraqitur në programin dhe tekstet shkollore, bëhet me qëllim që të jetë më lehtë për t'u mësuar nga nxënësi, të jetë më e organizuar dhe që të ketë vlerë përdorimi edhe pas studimit, më vonë, pas përfundimit të shkollës.

### **3.1.4. Njohuritë për metodat mësimore**

Zotërimi i këtyre njohurive e bën mësuesin të ndërgjegjshëm për strategjitë e ndryshme mësimore, me anë të të cilave ai vë në përdorim sjelljet kryesore dhe ato ndihmëse. Në kuadrin e metodave mësimore, mësuesi merr edhe vendimet si këto:

- Ritmi i përshtatshëm për materialin që do të mësohet
- Mënyra e paraqitjes së materialit
- Organizimi i klasës
- Menaxhimi i klasës

Të gjitha këto vendime janë në koherencë me njëra tjetrën dhe të lidhura me objektivat e mësimimit. Pra gjithë planifikimi është një proces, ndërsa plani është gjendje – rezultat i planifikimit. Disa nga llojet e planifikimit që projekton nxënësi janë:

- VJETOR
- SEMESTËR (GJYSËMVJETOR)
- MUJOR
- JAVOR
- DITOR
- TË NJË ORE MËSIMORE

### ***3.2. PËRBËRËSIT E PLANIT DITOR***

Plani ditore mund të zbatohet në mënyra të ndryshme. Për të organizuar mësimdhënien, më parë duhet përgatitur planin ditore, dhe kjo jep një përfundim se edhe përgatitja e planit ditore është liri e mësuesit. Mësuesi është i lirë të zgjedhë ato modele që i përshtaten kushtëve të tij, madje, edhe mund të krijojë modele të reja, bazuar në elementet kryesore të planifikimit, duke patur gjithnjë në mendje atë që është e detyrueshme për të: realizimin e objektivave mësimore, për të patur të nxënë të nxënësve.

Pasi vendos objektivat, mësuesi përcakton metodat që do të jenë të efektshme në udhëheqjen e nxënësve drejtë arritjes së secilit objektiv. Mësuesi fillon planifikimin, pasi të ketë përcaktuar më

parë objektivat mësimore. Në procesin e mësimimit ndodh mësimdhënia dhe të nxënët. Të nxënët i referohet ngjarjeve të brendshme që ndodhin brenda kokës së nxënësve. Seritë e hapave që ndjekë mësuesi në planifikim merr parasysh se ndodhitë e mësimimit do të ndikojnë të nxënët. Por nuk është e pazakontë që mësimdhënia të mos lidhet me të nxënët. Kjo ndodhë kur mësuesi zhvillon mësimin dhe nxënësi dëgjojnë, por që nuk kanë asnjë lidhje midis tyre, që këto dy procese të lidhen natyrshëm me njëri tjetrin, që përmes mësimdhënies të ndodhë të nxënët, është e rëndësishme që ndodhitë e mësimimit të marrin parasysh ndodhitë e të nxënët, përfshirjen aktive të nxënësve në procesin e të nxënët.

### **3.3. STRUKTURA PËR MËSIMDHËNIEN DHE ZHVILLIMIN E TË MENDUARIT**

Struktura për të menduarit dhe të nxënët është një procedurë përmes së cilës mësuesit udhëheqin nxënësit. Ajo jo vetëm mund të përshkruhet për çdo pjesë të saj, por mund të perceptohet edhe si strategji e ndërfutur edhe mjaft e lidhur. Struktura është e zhvilluar rreth përmbajtjes së një mësimi. Ajo nuk është e kufizuar vetëm në përmbajtjen e mësimimit, por është e zbatueshme në të gjitha situatat e të nxënët.

#### **Fazat e strukturës<sup>11</sup>**

**E I. Evokimi** (diskutimi para përmbajtjes) 1. Cila është tema? (dalloje atë) 2. Çfarë dini rreth saj? (radhitë në tabelë) 3. Çfarë prisni, dëshironi ose keni nevojë të mësoni rreth saj? (radhitë në tabelë) 4. Çfarë doni të mësoni rreth saj?

**R II. Ralizim i kuptimit.** I bërë prej nxënësit, në kohën kur kërkon informacion relativ në parashikimet.

**R III. Reflektimi (diskutimi pas përmbajtjes)** 1. Çfarë mësuat? (zgjeroni pyetjet, sa më shumë të mundeni) 2. Bëni pyetje me kundërpërgjigje, për të nxjerrë informacionin e papërmendur në fazën e evokimit. 3. Pas përgjigjeve të pyetjeve, mund të pyesni: “Pse mendoni ashtu?”

Zbatimi i strukturës ndryshon në varësi të moshës dhe nivelit të nxënësve.

#### **3.3.1. Mendimi kritik dhe struktura ERR**

Mendimi kritik kërkon aftësi për të gjykuar dhe për të reflektuar, se çfarë di dhe mendon dikush. Përpara se të ndodhë kjo, nxënësit duhet të sjellin më parë njohuritë dhe arsyetimin e tyre në nivel të vetëdijshëm. Nxënësit shpesh dështojnë në risjelljen e njohurive, lidhur me informacionin e ri, me terma të kuptimshëm. Duke dështuar në gjallërimin e njohurive të

---

<sup>11</sup> Musai Gary D. Borich - Përkthyer nga Bardhyl Metodologji e Mësimdhënies. - Tiranë : ALBGRAF, 2003. - Vol. III.

përparshme, nxënësit mund të jenë konfuzë, të kenë mendime të paqarta dhe kontradiktore, të cilat mund të pengojnë të nxënët e ardhshëm. Për të menduar në mënyrë kritike, është thelbësore që nxënësit të njohin se çfarë dinë.

Mendimtarë kritik janë aktive, punojnë në mënyrë sistematike, reflektojnë ndaj njohurive bazë, për të ripërcaktuar vetën dhe kanë si tipar mënyrën se si perceptojnë botën e tyre gjatë rritjes dhe të nxënësve. Ajo që ndodhë kur nxënësit bëhen të vetëdijshëm dhe kontrollojnë proceset e tyre metanë njohëse është se bëhen më të aftë për të dëgjuar dhe kuptuar idetë e reja, skemat e reja, mënyrat e reja të vendosjes së informacionit dhe të koncepteve së bashku.

### 3.3.2. Evokimi

Gjëja e parë që bëhet në fazën e evokimit është rikujtimi i çdo gjëje që dinë ose mendojnë se dinë nxënësit rreth një teme apo çështjeje të caktuar. Më pas zhvillohet një diskutim në grupe dhe nxënësit plotësojnë idetë me njëri-tjetrin. Kjo është faza e parë, e fillimit të strukturës me tri faza për të menduarit dhe të nxënësve. Në klasë duke përdorur strukturën gjatë fazës së evokimit, nxënësve u kërkohet, shpesh të bëjnë një listë me anë të brainstorming për ato që ata dinë ose mendojnë se i dinë në fillim. Brainstorming bëhet në mënyrë individuale, disa herë në çifte dhe më pas me të gjithë grupin, mund edhe të shkruhen në tabelë idetë e nxënësve, pa ndonjë shqetësim nëse janë të sakta apo jo. Mësuesi mund të nxjerrë disa ide nga nxënësit, duke i pytur ata rreth ideve të cilat nuk janë diskutuar, por që kanë lidhje në lexim. Roli i mësuesit është të drejtojë dhe të kuptojë mendimin e të dëgjojë me kujdes idetë e nxënësve.

Në këtë fazë të parë mund të kryhen veprimtari të ndryshme njohëse. Së pari nxënësi është i përfshirë aktivisht në rikujtimin e asaj që di rreth një teme, kjo e përqendron atë të shqyrtojë njohuritë dhe të fillojë të mendojë rreth asaj që së shpejti do ta shqyrtojë më hollësisht. E rëndësishme është që në veprimtarinë fillestare nxënësi vendos një nivelin bazë të njohurive vetjake, të cilave mund t'u shtohen njohuri të tjera. Procesi i të nxënësve është process i lidhjes së njohurive të reja me ato që dihen.

Qëllimi i dytë i fazës së evokimit është të aktivizojë nxënësin. Të nxënësve është më shumë një veprimtari aktive, se pasive. Shpesh nxënësit qëndrojnë në mënyrë pasive në klasë, duke dëgjuar në mënyrë të pavëmendshme mësuesin, mbajnë shënime apo “shohin ëndrra me sy hapur”. Përmes përfshirjes aktive, nënkuptohet që nxënësit duhet të bëhen të ndërgjegjshëm për të menduarit, duke përdorur gjuhën e tyre. Më pas, ata duhet të shprehin njohuritë dhe arsyetimin e tyre në të menduarit aktiv, në të shkruarit apo të folurit.

Qëllimi i tretë i fazës së evokimit është kryesor, përmes kësaj faze, vendoset interesi dhe qëllimi për shqyrtimin e temës. Interesi dhe qëllimi janë thelbësorë për të ruajtur zotimin aktiv të nxënësve. Të nxënësve e qëllimshëm është më i frytshëm se të nxënësve e paqëllimshëm.

### **3.3.3. Realizimi i kuptimit**

Kjo është faza në të cilën lexuesi vjen në kontakt me informacionin apo idetë e reja. Ky kontakt mund të arrihet duke marrë formën e tekstit të leximit, duke shikuar një film, duke dëgjuar një fjalim ose duke bërë një eksperiment. Kjo po ashtu është faza e të nxënësit, gjatë së cilës mësuesit kanë ndikim më të pakët tek nxënësi. Në këtë fazë mund të përdoren strategji të mësimdhënies që i ndihmojnë nxënësit të marrin pjesë në mënyrë të qëndrueshme, mund të përdoren teknika të ndryshme për të mbajtur shënime.

Detyra thelbësore e kësaj faze të dytë, realizimi i kuptimit, është së pari, ta mbajë nxënësin të përfshirë, të ruajë interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazes së evokimit. Detyra e dytë thelbësore është të mbështetë përpjekjet e tij për të kontrolluar të kuptuarit. Në këtë fazë, ata janë duke vendosur lidhje midis njohurive që dinë dhe njohurive të reja për të arritur te një arsyetim i ri.

### **3.3.4. Reflektimi**

Faza e tretë e strukturës është faza e reflektimit. Gjatë fazës së reflektimit, lexuesit përforcojnë të nxënësit e ri dhe, në mënyrë aktive, rindërtojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja. Është po kjo fazë në të cilën nxënësit me të vertetë marrin njohuri të reja vetë. Këtu ndodhë të nxënësit e qëndrueshëm, të nxënësit është një veprim për të ndryshuar, i cili ndodhë në mënyrë të shumëllojshme. Në këtë fazë, në radhë të parë, nxënësit priten të fillojnë të shprehin me fjalët e veta, idetë dhe informacionin që ndeshin. Kjo është e rëndësishme për ndërtimin e planeve të reja.

Qëllimi i dytë i kësaj faze është nxitja e shkëmbimit të fuqishëm të ideve midis nxënësve, në lidhje me zgjerimin e fjalorit shprehës, ashtu sikurse ekspozimi i tyre në plane të ndryshme për nxënësit, për të marrë në konsideratë kur e ndërtojnë vetë. Duke lejuar diskutimin gjatë fazes së reflektimit, nxënësit janë të ekspozuar ndaj një shumëllojshmërie ndërtimesh që duhet marrë parasysh.

Struktura ERR, kur zbatohet në mësimdhënie, u jep mësuesve një përmbajtje në të cilën paraqiten përvojat e të nxënësit, që i aftësojnë ata të udhëheqin nxënësit në procesin e të nxënësit. Kjo i pajis mësuesit me një kontekst në të cilin ata mund: të gjallërojnë të menduarit e nxënësve, të caktojnë qëllimet për të nxënësit, të sigurojnë diskutim të pasur, të motivojnë të nxënësit e nxënësve, të përfshijnë në mënyrë aktive nxënësit në procesin e të nxënësit, të nxit reflektim, të paraqitin nxënësit në opinione të ndryshme, të ndihmojnë nxënësit të bëjnë pyetjet e tyre etj.

## KAPITULL IV

### 4. METODA DHE STRATEGJI TË MËSIMDHËNIES

#### 4.1. PËRMBLEDHJA E STRUKTURUAR

Përmbledhja e strukturuar është një udhëzim ose shpjegim i shkurtër që jepet në fillim të mësimit për të ngjallur kureshtjen e nxënësve, për të paraqitur koncepte kyçe dhe për t'i përgatitur ata të përfitojnë nga mësimi.

**ARSYETIMI:** Teoritë e të nxënësve theksojnë që nxënësit mësojnë duke lidhur informacionin e ri me atë që dinë. Por nëse njohuritë ekzistuese për një temë janë të paplota apo jo koherente, është mirë të bëhet një përmbledhje e shkurtër e asaj që dihet për temën, për t'i përgatitur nxënësit për informacionin e ri. Përmbledhja e strukturuar i lejon mësuesit t'i japë nxënësve aq informacion sa duhet që, pastaj ata mund të mësojnë më tej nga teksti.<sup>12</sup>

**MADHËSIA E GRUPIT:** Gjashtë deri gjashtëdhjetë.

**KOHA E KËRKUAR:** Përmbledhja e strukturuar duhet të jetë e shkurtër-zakonisht jo më shumë sesa pesë minuta.

#### **VEPRIMTARIA:**

**Hapi 1:** Mendoni për mësimin dhe vendosni se cilat ide dhe çështje të tij janë interesante dhe të njohura për nxënësit. Se çfarë konceptesh dhe fjalë duhet të kuptojnë nxënësit që të mund të mësojnë. Bëni një listë të tyre.

**Hapi 2:** Përgatisni harta apo diagrame, ose sillni në klasë objekte që ngjallin interesin e nxënësve.

**Hapi 3:** Mbani një leksion të shkurtër, jo më shumë se 5 minuta, ku paraqesin pikat kryesore.

**Hapi 4:** Leksioni duhet të jetë interesant dhe ndërveprues: bëni pyetje dhe nxitni nxënësit që të bëjnë komente.

**Hapi 5:** Mbylleni duke thënë: "Të shohim." Pra krijoni një ndjenjë pritshmërie.

**REFLEKTIMI:** Përmbledhja e strukturuar duhet të jetë e shkurtër. Ajo ka për qëllim t'u japë nxënësve informacion të mjaftueshëm për aq sa ata të jenë në gjendje të marrin pjesë në një mësim aktiv, por nuk duhet që ky informacion të zëvendësojë mësimin aktiv.

---

<sup>12</sup> Charles Temple Alen Crawford, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster Strategji të Mësimdhënies dhe të nxënësve. - New York : Përkthyer nga Bardhyl Musaj, 2010. - Vol. I.

## 4.2. DI – DUA TË DI - MËSOVA (DDM)

Veprimtaria DDM mund të përdoret për të strukturuar një mësim të tërë. Ajo kërkon nga nxënësit që të mendojnë çfarë dinë për temën, të bëjnë pyetje për të, si dhe të gjejnë përgjigje për këto pyetje.<sup>13</sup>

**ARSYETIMI:** Teoritë e të nxënësve thonë që të nxënësve aktiv është më i mirë se ai pasiv. Nxënësit nxënë më mirë kur ata (1) kujtojnë atë që dinë, (2) bëjnë pyetje, (3) konfirmojnë njohuritë. Kjo metodë i shtynë ata t'i bëjnë të trija.

**MADHËSIA E GRUPIT:** Gjashtë deri në gjashtëdhjetë.

**KOHA E KËRKUAR:** 45 minuta deri në disa orë mësimi.

### VEPRIMTARIA:

**Hapi 1:** Filloni duke thënë temën dhe u kërkon nxënësve të mendojnë se çfarë dinë për të. Është mirë që nxënësit t'i shkruajnë idetë në një listë dhe t'i diskutojnë ato me një partner përpara se të përgjigjen.

**Hapi 2:** Vizatoni një tabelë DDM në tabelën e shkrimit.

**Hapi 3:** U kërkon nxënësve të thonë çfarë dinë për temën. I shkruani idetë e tyre në kolonën Çfarë dimë? Teksa i thonë mendimet, ju mund t'i organizoni ato në kategori.

**Hapi 4:** Tani kërkon nga nxënësit të mendojnë se çfarë pyetjesh kanë për temën. Ata mund të fillojnë duke rishikuar ato që dinë dhe të gjejnë fusha ku njohuritë e tyre janë të paplota. I shkruani pyetjet e tyre në tabelë në kolonën Çfarë duam të dimë? Mund të shtoni edhe idetë.

**Hapi 5:** Tani nxënësit duhet të lexojnë tekstin (ose të dëgjojnë udhëzimet e mësuesit, ose të bëjnë ndonjë hulumtim tjetër). U kujtoni që duhet të kërkojnë të gjejnë përgjigjet për pyetjet e tyre, si edhe ndonjë ide që nuk e kishin parashikuar.

**Hapi 6:** Nxënësit raportojnë për gjërat që mësuam nga teksti. Së pari, raportojnë për përgjigjet që kanë gjetur për pyetjet e tyre, dhe, pastaj, për ndonjë ide interesante apo të rëndësishme që kanë zbuluar. Mësuesi i shënon këto në tabelë, në kolonën Çfarë mësuam?

**REFLEKTIMI:** Metoda DDM është një mënyrë shumë e mirë për të strukturuar një mësim që trajton një temë informative. Ajo nuk rekomandohet për vepra letrare. Në qoftë se nxënësit nuk kanë shumë njohuri paraprake për një temë, metoda DDM mund të paraprihet me një organizues paraprak.

---

<sup>13</sup> Charles Temple Alen Crawford, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster Strategji të Mësimdhënies dhe të nxënësve [Book]. - New York : Përkthyer nga Bardhyl Musai, 2010. - Vol. I.

### 4.3. SHKRIM I SHPEJTË

Shkrimi i shpejtë është reflektimi i shkurtër për një temë.<sup>14</sup>

**ARSYETIMI:** Shkrimet e shkurtra janë ese joformale, domethënë shkrime ku vëmendja përqendrohet më shumë tek begatia e fakteve dhe brendia e pasur, sesa tek organizimi formal gjuhësor i thënieve. Shkrimet e shpejta duhet të jenë joformale-ideja është të mbahen shënime mendimet dhe jo të shqetësohemi për stilin.

**MADHËSIA E GRUPIT:** Çfarëdo madhësie.

**KOHA E KËRKUAR:** Shkrimi i shpejtë mund të bëhet 5 deri 10 minuta. Ai mund të përdoret në fillim, në mes ose në fund të mësimit.

**VEPRIMTARIA:**

*Hapi 1:* U thoni nxënësve që të shkruajnë shumë shkurt për një temë që do t'u jepni.

*Hapi 2:* Thoni temën.

*Hapi 3:* Matni kohën, ndërsa nxënësit shkruajnë. (Mund t'i lini një minutë më shumë.)

*Hapi 4:* Nxënësit mund t'i mbajnë fletët në fletore ose mund t'i mblidhni për t'i përdorur në vlerësimin e mësimit.

Shkrimi i shpejtë është një mundësi për të shkruar një temë, ose për t'u përgjigjur një pyetjeje, vetëm për një ose dy minuta jo më shumë sesa pesë minuta. Nxënësit duhet të shkruajnë shpejtë dhe pa e shkëputur lapsin nga letra, në njëfarë kuptimi “të mendojnë me zë”. Përqendrimi duhet të jetë mbi atë që po shkruajnë dhe jo si po shkruajnë. Mësuesi mund t'u kërkojë disa nxënësve që të lexojnë atë që kanë shkruar. Strategjia e shkrimit të shpejtë përdoret shpesh si një veprimtari përshkrimi ose përforcimi. Shkrimi i shpejtë mund të përdoret në çdo lëndë.<sup>15</sup>

### 4.4. STUHIA E MENDIMEVE

Metodë për të nxitur e përfituar ide për një temë.

**ARSYETIMI:** Parimi i stuhisë së mendimeve parakupton që të mendohen shumë ide, të jepen ide të ndryshme dhe të mos bëhen gjykime për to, deri sa nxënësit të kenë dhënë një larmi idesh. Stuhia e mendimeve ndihmon në hapjen e mendjeve të nxënësve, duke menduar ide që zakonisht nuk kishin për t'u shkruar ndërmend. Jo të gjitha idetë që do të japin nxënësit do të jenë njëlloj të dobishme; ata mund të zbulojnë disa ide të vlefshme, midis disa ideve më pak të rëndësishme.

---

<sup>14</sup> Charles Temple Alen Crawford, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster Strategji të Mësimdhënies dhe të nxënësve - New York : Përkthyer nga Bardhyl Musai, 2010. - Vol. I.

<sup>15</sup> Charles Temple Alen Crawford, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster Strategji të Mësimdhënies dhe të nxënësve - New York : Përkthyer nga Bardhyl Musai, 2010. - Vol. I.



Nxënësit që praktikojnë stuhinë e mendimeve shpesh bëhen më të lirshëm dhe më pak të ngurtë në mendimet e tyre.

**MADHËSIA E GRUPIT:** Stuhia e mendimeve mund të bëhet nga individë, dyshe, grupe të vogla ose tërë klasa.

**BURIMET:** Stuhia e mendimeve kërkon vetëm laps e letër, ose dërrasë të zezë dhe shkumës për t'i shënuar idetë.

**KOHA E KËRKUAR:** Veprimtaria e stuhisë së mendimeve mund të kryhet në 10 minuta ose më pak.

**VEPRIMTARIA:**

*Hapi 1:* U flisni nxënësve se çfarë duhet të bëjnë në stuhinë e mendimeve.

*Hapi 2:* Paraqitni shumë qartë temën ose problemin.

*Hapi 3:* U jepni nxënësve një afat kohor për ta zgjidhur problemin.

*Hapi 4:* I nxisni që t'i thonë të gjitha idetë që lidhen me temën, sado të çuditshme që t'u duken. Kujtojini që nuk duhet t'i kritikojnë idetë e të tjerëve. Nxitni që të ndërtojnë argumente mbi idetë e njëri-tjetrit.

*Hapi 5:* Shkruajini idetë, siç thonë nxënësit.

*Hapi 6:* Më vonë, nxënësit mund të bëjnë stuhi mendimesh më vete ose në dyshe.

#### ***4.5. STUHI MENDIMESH NË DYSHE***

Zbatimi i stuhi mendimesh në dyshe kërkon nga nxënësit të shkruajnë secili idetë e tyre për një temë. Pastaj, pas disa minutash, u kërkoni të krijojnë dyshe, të shkëmbejnë mendimet dhe të shtojnë mendime të tjera në listat e tyre. Më vonë mund t'u kërkoni dysheve t'i thonë idetë e tyre para klasës, ndërkohë mësuesi duhet ti shkruan në tabelë.<sup>16</sup>

#### ***4.6. LËVIZ/NDALO/KRIJO DYSHE***

Lëviz/ndalo/krijo dyshe, është një mënyrë e gjallë për t'i bërë nxënësit të punojnë me partnerë të rinjë, për të kryer një detyrë të përcaktuar qartë.

---

<sup>16</sup> Charles Temple Alen Crawford, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster Strategji të Mësimdhënies dhe të nxënësve, - New York : Përkthyer nga Bardhyl Musai, 2010. - Vol. I.

**ARSETIMI:** Levizja nëpër klasë i bën nxënësit më të gjallë e më të gatshëm për mësim. Gjetja e një partneri të rastësishëm për të zgjidhur problemet me të zhvillon shprehitë sociale, sidomos aftësinë për të bashkëpunuar në zgjidhjen e problemeve.

**MADHËSIA E GRUPIT:** Gjashtë deri në gjashtëdhjetë.

**KOHA E KËRKUAR:** Duhet bërë shpejtë, në 2 deri në 5 minuta.

**VEPRIMTARIA:**

*Hapi 1:* Paraprakisht mendoni një pyetje ose një grup pyetjesh.

*Hapi 2:* Jepni udhëzimet në kohë, për të shmangur rrëmujën! U thoni nxënësve se, kur t’u bëni shenjë, ata duhet të çohen dhe të levizin nëpër dhomë. Kur të thoni “Ngrij!”, ata duhet të qëndrojnë në vend dhe të krijojnë dyshe me personin më të afërt.

*Hapi 3:* Bëni shenjën. Lëreni të levizin për një minute. Pastaj thoni “Ngrij!” dhe u jepni detyrën.

*Hapi 4:* U jepni nxënësve një sasi të caktuar kohe për ta kryer detyrën. Pastaj u thoni të kthehen nëpër vende.

#### **4.7. LAPSAT NË MES**

Një strategji e të nxënësve në bashkëpunim, që i ndihmon nxënësit ta ndajnë kohën në mënyrë të barabartë.<sup>17</sup>

**ARSYETIMI:** Në grupet e të nxënësve bashkëpunues, ndodhë që një nxënës mbizotëron në diskutim. Nxënësit e tjerë e kanë të vështirë të thonë diçka. Lapsat në mes është një metodë që ka për qëllim të sigurojë që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të marrin pjesë në një grup të të nxënësve bashkëpunues, dhe e nxit mësuesin t’u kërkojë nxënësve të thonë mendimin e tyre.

**MADHËSIA E GRUPIT:** Lapsat në mes ka rezultat me grupe të vogla, me 3 deri 10 nxënës.

**BURIMET:** Nxënësit duhet të kenë vetëm një laps ose stilolaps.

**KOHA E KËRKUAR:** Veprimtaria kryhet në të njejtën kohë që nxënësit bëjnë një detyrë tjetër në grup.

**VEPRIMTARIA:**

*Hapi 1:* Kur nxënësit fillojnë të thonë idetë e tyre në një grup tipik të të nxënësve bashkëpunim me tre deri në shtatë anëtarë, secili nxënës shënon kontributin e vet, duke vendosur lapsin në tavolinën e mesit.

---

<sup>17</sup> Charles Temple Alen Crawford, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster Strategji të Mësimdhënies dhe të nxënësve. - New York : Përkthyer nga Bardhyl Musai, 2010. - Vol. I.

**Hapi 2:** Ai nxënës nuk duhet të flasë më, derisa të gjithë anëtarët e tjerë të grupit të kenë vënë lapsat në tavolinë. Kështu, të gjithë anëtarët kontibojnë në mënyrë të barabartë dhe asnjë nuk mbizotron.

**Hapi 3:** Një nxënës që nuk ka kontribuar dhe që nuk ka ndonjë gjë për të thënë, thotë “pas”, dhe vendos lapsin në tavolinë.

**Hapi 4:** Në çdo çast, mësuesi mund të shkojë tek grupi, të zgjedhë një laps në tavolinë dhe të pyes se çfarë ka thënë i zoti i lapsit.

**SUGJERIME:** Kur nxënësit diskutojnë një çështje në grupe të vogla, një mënyrë tjetër për t’u siguruar që të gjithë do ta kenë mundësinë të flasin dhe do të flasin është që ata të kalojnë një send (një gur, një top të vogël) nga folësi në folës. Vetëm ai që ka sendin në dorë mund të flasë.

#### **4.8. SHKËMBE NJË PROBLEM**

Shkëmbe një problem është një veprimtari bashkëpunuese që kërkon nga nxënësit të gjejnë një çështje të rëndësishme në një temë studimi dhe pastaj të formulojnë për të një problem që duhet ta zgjedhë një grup tjetër.<sup>18</sup>

**ARSYETIMI:** Kjo metodë i mësonë nxënësit të identifikojnë a njëjtësojnë çështje të rëndësishme në lëndën mësimore, të formulojnë problem për ato çështje dhe të ndërveprojnë me të tjerët.

**MADHËSIA E GRUPIT:** Metoda ka më shumë rezultat në qoftë se nxënësit punojnë në grupet bazë prej katër vetash. Mund të punohet edhe me grupe pesëshe, në qoftë se është e nevojshme. Numri i grupeve në klasë nuk ka rëndësi.

**BURIMET:** Metoda nuk kërkon ndonjë mjet të veçantë. Mirë është që çdo nxënës të ketë letër e laps për të shënuar idetë.

**KOHA E KËRKUAR:** Veprimtaria kërkon 15 deri 40 minuta.

#### **VEPRIMTARIA:**

**Hapi 1:** Kërkojini secilit grup ta shkruajë problemin në një cope letër dhe t’ia jape atë një grupi tjetër.

**Hapi 2:** Grupi duhet ta zgjedhë problemin. Pasi të kenë marrë problemin e parashtruar, secili grup ka një kohë të caktuar për të menduar zgjidhjen e tij.

---

<sup>18</sup> Charles Temple Alen Crawford, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster Strategji të Mësimdhënies dhe të nxënës, - New York : Përkthyer nga Bardhyl Musai, 2010. - Vol. I.

**Hapi 3:** (Sipas dëshirës) Pasi ta ketë zgjidhur problemin, grupi mund të planifikojë ecurinë për të paraqitur atë problem dhe zgjidhjen e tij dhe ia paraqiti një grupi tjetër. Kur ta zbatojnë këtë ecuri, ata duhet: të tregojnë rrugën dhe të japin përgjigjen, t'i përfshijnë edhe nxënësit e tjerë në mësim.

#### **4.9. RUAJE FJALËN E FUNDIT PËR MUA**

Ruaje fjalën e fundit për mua mundëson organizimin e një diskutimi teksti në klasë, qoftë narrativë apo shpjegues. Kjo strategji është veçanërisht e dobishme për t'i bërë nxënësit më të heshtur e më të turpshëm që të marrin pjesë në diskutimet në klasë.

**ARSYETIMI:** Gjatë diskutimeve në klasë, shpeshë janë mësuesit ata që thonë “fjalën e fundit” për një temë. Por, duke u dhënë mundësinë nxënësve të thonë fjalën e fundit, ata i motivojnë nxënësit t'i thonë idetë dhe të ndjehen të rëndësishëm. Metoda, Ruaje fjalën e fundit për mua u mëson nxënësve të identifikojnë çështjet që kanë interes në një tekst që kanë lexuar dhe të marrin përgjegjësinë për diskutimin në klasë.

**MADHËSIA E GRUPIT:** Ruaje fjalën e fundit për mua bëhet me të gjithë klasën.

**BURIMET:** Për Ruaje fjalën e fundit për mua duhen copa letre, ku nxënësit të shkruajnë komentet e tyre. Gjithashtu duhet edhe një tekst për t'u lexuar ose një temë për t'u marrë në shqyrtim.

**KOHA E KËRKUAR:** Veprimtaria mund të kryhet në 20 deri 40 minuta.

#### **VEPRIMTARIA:**

**Hapi 1:** Përpara se nxënësit të lexojnë tekstin, mësuesi u thotë që të gjejnë në tekst pjesë që u bëjnë përshtypje, i çudisin, i entuziazmojnë apo i zemërojnë.

**Hapi 2:** Nxënësit i shkruajnë këto pjesë në njërën anë të copes së letrës. Duhet të mos harrojnë të vënë numrin e faqës nga e kanë marrë.

**Hapi 3:** Në anë tjetër të letrës, nxënësit duhet të shkruajnë komentin e tyre. Domëthënë, duhet të shkruajnë se çfarë i çuditi, entuziazmoi, zemeroi etj.

**Hapi 4:** Gjatë orës tjetër të mësimin, mësuesi u kërkon nxënësve, një nga një, të lexojnë citimet që kanë nxjerrë (por jo komentet). Ai nxënës që lexon citimin duhet të drejtojë atë pjesë të orës së mësimin, duke i ftuar nxënësit e tjerë të bëjnë komentet e tyre për të. Edhe mësuesi mund të bëjë komente, por vetëm mbasi të kenë folur disa nxënës, dhe kur dihet se do të ketë komente dhe nga nxënës të tjerë.

**Hapi 5:** Pasi nxënësve u është dhënë mundësia të komentojnë, ai që kishte zgjedhur citimin, kthen fletën nga ana tjetër dhe lexonë komentin. Kjo është fjala e fundit. Asnjë nxënës tjetër, e as mësuesi, nuk kanë të drejtë të komentojnë pas tij.

**Hapi 6:** Mësuesi thërret nxënës të tjerë të lexojnë citimet e tyre dhe të drejtojnë diskutimin në klasë. Edhe mësuesi mund ta bëjë këtë një herë. Nuk është e nevojshme që të gjithë nxënësit të lexojnë citimet e tyre. Pesë ose gjashtë mjaftojnë për një orë mësimore.

**REFLEKTIMI:** Po që se mësuesi është mësuar të japë vazhdimisht udhëzime, ai ka për t'u habitur se sa shumë çështje nga ato që kanë shënuar mësuesi në udhëzimet e veta do të dalin nga nxënësit gjatë veprimtarisë Ruaje fjalën e fundit për mua!

#### **4.10. SHKRIMI I LIRË**

Shkrimi i lire është i ngjajshëm me shkrimin e shpejtë, por për të jepet më shumë kohë. Për rreth pesë ose dhjetë minuta, mësuesi mund t'u kërkojë nxënësve të shkruajnë sa më shumë që të mundën për një temë. Pastaj mësuesi mund t'u japë edhe një minutë tjetër për të përfunduar mendimin e fundit që po shkruajnë. Nxënësve duhet t'u jepen mundësi për t'i ndarë idetë e tyre me të tjerët. Më shpesh shkrimi i lirë bëhet si veprimtari përforcimi, por mund të përdoret edhe si veprimtari parashikimi.

#### **4.11. DITARI DYPJESËSH**

Ditari dy pjesësh është një strategji që i bën nxënësit të lexojnë për të kuptuar dhe pastaj të ndërveprojnë me idetë që hasin. Ditari dy pjesësh nuk është i vështirë të bëhet. Nxënësi duhet vetëm të bënë një vijë vertikale në mes të fletorës. Në të majtë, nxënësi vë citime nga teksti, që i kanë bërë përshtypje ose që i kanë pëlqyer më shumë. Në të djathtë, ata shkruajnë një koment për citimin që kanë vënë në të majtë.

Pasi nxënësit kanë lexuar dhe kanë shënuar mendimet e tyre, u kërkoni disave prej tyre t'i thonë para klasës. Pyetni nxënësit se pse disa nga këto ide u janë dukur aq të rëndësishme sa për t'u mbajtur shënim.

Edhe mësuesit duhet t'i lexojnë idetë që ata vetë kanë shkruar për tekstin dhe pse iu dukën të rëndësishme. Ky demonstrim u tregon nxënësve procesin e të menduarit të mësuesit.<sup>19</sup>

---

<sup>19</sup> Po, aty, fq 156.

### *Ditari dypjesësh (Shembull):*

Pjesë nga teksti

Reflektime

Qytetarët zgjedhin udhëheqësit e tyre.

Po në vendin tim, pse kjo nuk bëhet?

Të gjithë kanë të drejta të barabarta.

Po gratë? Po të varfërit? Duket sikur ata nuk kanë asnjë të drejtë. Kjo më inatos shumë.

Arsimi për të gjithë.

Edhe të varfërit mund të shkojnë në universitet. Ndoshta edhe unë mund të shkojë

### **4.12. STUDIMI NË DYSHE**

Studimi në dyshe është një procedure e të studiuarit kur dy nxënës punojnë pa ndihmën e mësuesit. Studimi në dyshe përbëhet nga pesë hapa: puno, kupto, mësoi tjetrit, jep mendime dhe shkëmbe<sup>20</sup>:

**1.Puno:** të dy lexuesit vendosin se cilën pjesë të tekstit do të lexojnë dhe për sa kohë do ta lexojnë: (pjesa mund të jetë nga disa faqe, deri në tërë kapitullin e librit).

**2.Kupto:** lexuesit lexojnë të njëjtën pjesë të materialit. Ata përqendrohen tek të kuptuarit në përgjithësi, dhe jo tek mbajtja mend e të gjithë materialit. Ata shënojnë pjesët e rëndësishme dhe të vështira në tekst. Ata vendosin se cili prej tyre do t'i japë mësim tjetrit, dhe cilën pjesë.

**3.Mësoi tjetrit:** njëri partner merr rolin e mësuesit, për një pjesë të tekstit. Ai i shpjegon tjetrit materialin dhe i bën pyetje për të.

**4.Jep mendime:** lexuesi tjetër, që luan rolin e nxënësit, e dëgjon “mësuesin”. I vë në dukje gabimet, nese ka, dhe i bën pyetje për materialin. Ky rol është i vështirë, sepse “mësuesit” duhet t'i kërkohet vazhdimisht që të jenë sa më të qartë, që procesi të ecë sa më mirë.

**5.Shkëmbe:** pasi “mësuesi” mbaron mësimdhënien, nxënësi përmbledh ato që ka thënë ai. Të dy nxënësit diskutojnë materialin, shkëmbejnë ato që kanë mësuar dhe krijojnë pyetje për të. Ata bien në një mendje se cilat janë idetë kryesore të materialit. Prosesi vazhdon njësoj edhe për pjesët e tjera të materialit. Nxënësit ndërrojnë rolet me radhë.

<sup>20</sup> Charles Temple Alen Crawford, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster Strategji të Mësimdhënies dhe të nxënësive - New York : Përkthyer nga Bardhyl Musai, 2010. - Vol. I.

## KAPITULLI V


### 5. REZULTATET E HULUMTIMIT

Në kuadër të realizimit të këtij punimi kam kryer edhe nje hulumtim në fushën përkatëse të strategjisë të mësimdhënies dhe të nxënit përkatësisht me mesimdhënës dhe nxënës dhe për këtë kam përzgjedhur shkollën ku kam përfunduar shkollimin fillor, SHFMU “Haxhi Hoti” - Rogovë.


#### 5.1. REZULTATET E HULUMTIMIT ME MËSIMDHËNËS

Në vijim janë të listuara pyetjet bashkangjitur me pergjigjet e anketuesve dhe në fund përfundimet:


1. Si keni arritur të ndërtoni raporte të mira me nxënësit?




2. A jeni të kënaqur me organizimin dhe format e avancuara të mësimdhënies?




3. Cilën formë e përdorni për të nxitur të mësuarit aktiv?



4. Disa nga metodat që shfrytëzoni gjatë procesit mësimor:




5. Cila metodë është treguar më efektive dhe ka sjellur rezultate në të nxënë?







6. Përdorimi i metodave është treguar më i mirë në punë?




7. Prioritet në të cilat duhet të fokusohemi për të mbështetur suksesin e nxënësve?




8. Cilat janë masat që ndërmerri ndaj nxënësve problematik?




9. Mesatarisht sa herë kontaktoni me prindër për nxënësit e klasës tuaj:



10. Si e përceptoni disiplinën në klasën tuaj?



11. Cili model planifikoni ta përdroni apo e përdorni në procesin e notimit vlerësimit të nxënësve?




Në këtë pyetësor të anketuarit ishin 9 mesimdhënës. Mesimdhënësit në pyetësor nuk kanë pasur opsione për përgjigje, pra përgjigjet janë shkruar nga vetë ata.


## 5.2. REZULTATET E HULUMTIMIT ME NXËNËS

Në vijim janë të listuara pyetjet bashkangjitur me përgjigjet e anketuesve dhe në fund përfundimet:


1. Si qëndrojnë raportet e juaja me mësuesin?




2. Lënda e mësimit ju bëhet më tërheqëse sepse?




3. Mësuesit në shkollë ju trajtojnë si?




4. Sa jeni të vëmendëshëm gjatë procesit mësimor?




5. Cila lëndë ju pëlqen më shumë dhe metoda që ju pëlqen te ajo lëndë?




6. Përmend disa nga metodat që punoni në klasë me mësuesin?




7. Cilat nga metodat në orën mësimore të pëlqen më shumë?




8. Cilat nga metodat në orën mësimore për ty janë më të vështira?



9. Pëlqeni më shumë punën individuale, çifte apo grupe?



#### 10. Sa jeni aktivë gjatë orës mësimore?



Nxënësit që ishin pjesësëmarrës në këtë pyetësorë ishin 21 dhe ishin nxënësit e klasës së pestë (V), pyetjet për ta ishin edhe me opsione mirëpo kishte edhe pyetje me shënime.

Me këtë hulumtim që e realizova gjatë punimit të temës së diplomës, arrita të marrë nga mësimdhënësit dhe po ashtu edhe nga nxënësit përgjigje të ndryshme gjatë procesit të mësimdhënies. U informova për strategjitë që mësimdhënësit përdorin në mësimdhënie, sa kanë sukses ato në punën e tyre me nxënës, cilat nga strategjit e vlersimit i përdorin ata, cilën form të punës e praktikojnë në klasë...,etj.

Gjithashtu mora edhe përgjigjet nga nxënësit të cilët u treguan mjaft real gjatë plotësimit të pyetësorit, në disa nga pyetjet e pyetësorit nxënësit kishin për të shënuar përgjigjen, në të cilën përgjigje ata kishin tregua metodat që punojnë në klasë, ato që ju pëlqejn më shumë të punojnë, metodat që për ta janë të vështira të punojnë, marrëdhëniet me mësuesin, puna që ju pëlqen të punojnë në klasë...etj.

Marrëdhëniet mësimdhënës nxënës ishin të shkëlqyera, këtë gjë e vërejtja gjatë përgjigjeve që u ishin bërë edhe nga mësuesi edhe nga nxënësit. Për të dyja palët, sikur për mësuesin ashtu edhe për nxënësit puna më e pëlqyer në klasë ishte puna në grupe, pasi në këtë formë pune nxënësit bashkëpunojnë me njëri tjetrin, shprehin secili mendimet e veta dhe në fund arrijnë në një përfundim që të gjithë grupi pajtoheshin. Nxënësit ishin të kënaqur me metodat që punojnë në klasë me mësuesin, gjithashtu edhe mësuesit pasi kishin vërejtur se me përdorimin e këtyre metodave edhe nxënësit ndjehen më të lirshëm në mësim.

## PËRFUNDIMI

Në këtë punim u trajtua tema “Strategji të mësimdhënies dhe të nxënësve”, u trajtua çështja e punës së mësuesit, mësimdhënia e mirë, mësuesi i suksesshëm, mësimdhënia efektive/mësimdhënësi efektiv, teoritë e të nxënësve, stilet e të nxënësve/mësuarit, planifikimi i mësimit, e shumë qka tjetër lidhur me këtë çështje, u trajtuan gjithashtu edhe strategji dhe metoda të ndryshme të cilat strategji tregojnë gjithë veprimtarinë hap për hap si duhet vepruar në klasë.

Ky punim fokusohet më së shumti tek strategjitë, metodat dhe teknikat me në qendër nxënësin duke u nisur nga fakti se përdorimi i metodave të ndryshme në mësimdhënie është shumë i rëndësishëm në mënyrën sesi nxënësi nxë. Shtysë për realizimin e kësaj teme ka shërbyer interesi im për përdorimin e këtyre metodave në mësimdhënie që do të zhvillojnë vitet në vijim, në funksion të mësimdhënies efektive dhe socializimit të nxënësve. Në përdorimin e këtyre metodave nxënësi është aktiv dhe më i lirë në shprehje.

Metodat e të mësuarit janë: rrugët, mënyrat, ecuritë dhe procedurat didaktike që mësuesit e nxënësit i përdorin gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij, për transmetimin dhe përvetësimin e njohurive, shkathtësive e shprehive, për zhvillimin e formimit e veçorive e të tipareve të personalitetit të individit. Historikisht metodat kanë evoluar, kanë ndryshuar, janë përsosur e modernizuar në përputhje me zhvillimet shoqërore, ekonomike dhe politike.

Sot në të gjitha ciklet e shkollimit, po aplikohet mësimdhënia e re, e cila vendos në qendër të mësimit nxënësin, kurse mësuesi është udhëheqësi dhe organizuesi i mësimit, që e udhëheq nxënësin për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin dhe në zgjidhjen e çdo problemi sado i ndërlikuar që të jetë.

Konceptet bazë të mësimdhënies me në qendër nxënësin janë:

- Më shumë mësimdhënie të hapur.
- Më pak të nxënë të drejtuar nga mësuesi.
- Mësimdhënia për të nxënë.
- Më shumë të nxënë bashkëvepruesë.

Gjatë përdorimit të metodave novatore mësuesi siguron në klasë një mjedis të sigurtë, bashkëpunues, inkuarues, të hapur, të rregullt dhe me komunikim të dobishëm ndërmjet nxënësve me anën e përdorimit të një game të gjerë strategjishë dhe teknikash, për të promovuar tek nxënësit vetëkontrollin, vetëdisiplinën, përgjësinë ndaj të tjerëve dhe pavarësinë e tyre.

Gjithashtu organizon shkëmbimin e përvojave të nxënësve ndërmjet nxënësve dhe anëtarëve të grupeve bashkëpunuese. Mësuesi organizon një menaxhim të tillë në klasë, nëpërmjet të cilit nxit reflektimin, shprehjet e interesave, vendosjen e qëllimeve dhe vetëvlersimin në realizimin e punëve me cilësi të lartë nga ana e nxënësve dhe rishikon vazhdimisht efektshmërinë e mësimdhënies dhe impaktin e tij mbi ecurinë e nxënësve, duke qartësuar arritjet e synuara, këshillon dhe drejton nxënësit për progresin e arritjeve të tyre.

## LITERATURA

Babaj Naim Planifikimi i Mesimit [Online]. - 11 16, 2015. - Maj 23, 2017. - <http://naimbabaj67.weebly.com/>.

Charles Temple Alen Crawford, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster Strategji të Mësimdhënies dhe të nxënit. - New York : Bardhyl Musai, 2010. - Vol. I.

GROUP ALBAS Portali Shkollor [Online] // Bota Shkollore në një vend. - ALBAS GROUP, 2015. - Maj 13, 2017. - <http://www.portalishkollor.al/>.

Marigona [Online] // Mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive. - Scribd, Mars 11, 2016. - 1.0. - Maj 10, 2017. - <https://www.scribd.com/doc/303932988/Mesimdhenea-Dhe-Mesimnxenia-Efektive>.

MASHT Mësuesi i Kosovës [Article]. - Prishtinë : Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Shkurt 2014. - Reviste e Permuajshme.

Musai Bardhyl Psikologji Edukimi. - Tiranë : PEGI, 1999. - Vol. I.

Musai Gary D. Borich - Përkthyer nga Bardhyl Metodologji e Mësimdhënies. - Tiranë : ALBGRAF, 2003. - Vol. III.

Sulollari E Profesionalizmi i mesuesit [Online] // Mësimdhënia. - Maj 5, 2017. - <https://sites.google.com/site/mshesmeraldasulollari/>.